

Gjekë Marinaj, Texas, SHBA

Bush: Shqipëria nën F

Edhe ish-Bashkimi Sovjetik e Kina k

Gjekë Marinaj ka lindur në Malsinë e Shko-drës në vitin 1965 dhe banon në Richardson të Texasit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ku është vendosur që nga viti 1990 kur u arratis nga Shqipëria për motive politike. Është diplomuar në Institutin Mjekësor ASPT dhe në pranverën e vitit 1977 ka mbaruar Kolegjin BROOKHAVEN për shkencat e përgjithshme. Aktualisht vazhdon vitin e tretë në Universitetin UTD për artet e letërsinë botërore, me nëndegë gazetarinë. Më 26 nëntor të vitit 1999 ka fituar çmimin "Pena e Artë" në një konkurs ndërkombëtar të poezisë që organizohet njëherë në vit nga universitetet e Amerikës.

Po kështu ai është botuar në Antologjinë "BEST POEMS OF THE 90s. (Poezitë më të mira të viteve 90-të) në vitin 1998. Ka botuar dy libra dhe dy të tjerë i ka në shtyp, e që nga viti 1996 është botues i gazetës "KOHËT E POETËVE" (shqip-anglisht). Gjithashtu Gjekë Marinaj ka një shtëpi botuese "MARINAJ PUBLISHING" ku kanë botuar emrat e njohur të diaporës shqiptare. Kërkesës sonë për një intervistë ekskluzive për "Gazetën" Marinaj iu përgjigj me kënaqësi duke intervistuar ish Presidentin e SHBA George Bush të cilën po e botojmë të plotë.

Nga Gjekë MARINAJ


Zgjedhjet e reja presidenciale në Amerikë, mbajnë në vetvete një peshë të madhe të fatit të së ardhmes së Kosovës dhe Shqipërisë. Edhe shqiptarët e Amerikës do të jenë pjesmarrës në këto votime. Fjala është të votojnë për George Bush apo për Al Gore. Sigurisht, secili do të ndjek bindet e tij politike. Por n gaqë kemi të bëjmë me një tjetër anëtar të familjes Bush, mendova se një bisedë me ish Presidentin George Bush do të ishte interesante për shqiptarët dhe diasporën.

Zoti President, deri tani NATO-ja ka bërë fare pak për sa i përket paqes në Botë. Cili mendoni se do të jetë misioni i saj në shekullin që vjen?

"Misioni i saj në këndvështrimin tim do të ishte mbajtja e paqes në zonën e saj, në Evropë. NATO-ja bëhet irelevante nëse gjithkush mund të bëhet

antare e saj. NATO-ja duhet të jetë tepër e kujdesshme në misionet që ndërmer në atë zonë. Nuk jam duke gjetur justifikime për Millosheviçin. Më tej, nuk jam duke kërkuar asnjë ndjesë për brutalitetin e paparë, për spastrimin etnik, as për përpjekjen për shkatërim sistematik të racës dhe kulturës të shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë mendoj se është mirë të dimë se këtu nuk kemi përdorim force nga ana hegjemonike. Millosheviçi nuk u mundua të pushtonte shtetin e dikujt tjetër. Ai justifikohet se mbronte shtetin e tij. Pra nuk kemi të bëjme me një diferencë të madhe në këtë kuptim. Nuk është një diferencë e madhe po ta krahasojmë atë me Hitlerin apo Saddam Hysenin, të cilët përdorën forcën për të pushtuar vendet e tjera. Ju më bëtë një pyetje mjaft të mirë. Pra për mendimin tim, misioni i NATO-s nuk duhet të zgjerohet jashtë Evropës".

Nëse NATO-ja mund të sjellë paqe ashtu siç solli në Bosnjë e më vonë në Kosovë, ç'rrezik paraqet zgjerimi dhe fuqizimi i saj? Nëse ajo nuk ndërhy kur është e nevojshme, atëherë ç'vlerë ka ekzistenca e saj?
"Nuk është mirë që kushdo që të dëshirojë të



Ish presidenti i SHBA George Bush

hyjë në NATO, të jetë i mirëpritur. Të jesh anëtar i saj duhet të përmbushësh disa kondita që nuk janë të pakta. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për përmbajtjen e ushtrisë dhe të teknologjisë ushtarake që e shoqëron atë. Këto janë disa nga parametrat që kanë të

bëjnë me suksesin e saj. Nëse këto parametra zgjerohen pa masë, do ta bënin NATO-n një organizatë që nuk do të ishte në gjendje të kryente me sukses misionin e saj të paqëmbajtjes as për vendet antare të saj, e aq më pak të vendeve të tjera".
Disa nga kritikët tuaj

nuk hezitojnë të thonë se po ta kishit kryer detyrën si duhet, ju dhe administrata juaj, për të prishur planet hitlerjane të Millosheviçit, as trupat amerikane dhe as shqiptarët e Kosovës nuk do të ishin ngatëruar në atë situatë lufte aq të vështirë. Cil është qëndrimi juaj në

Njoftime të AKP-së

SHITJE ME REZERVE

Agjencia Kombetare e Privatizimit shpall për shitje me rezerve objektet e me poshtme ne baze te VKM Nr 283 date 18.06.1999

Emertimi i objektit	Vendodhja	Vlera filles e ankandit	Vlera e M. te Xh	Vlera Totale e Objektit	Sip. e Objektit	Te dhena per	Zhvillimi	I Ankandit	
		(M Kryesore) ne leke	(ne leke)	(ne leke)	M2	veprim. e kryer	Data	Ora	Vendi
Banjo WC Nd Pastrimit	Berat	55000		55000	52.7		13.10.2000	10,00	AKP Tirane

Shenim : Cdo person fizik apo juridik si dhe ish pronaret e truallit te interesuar per te blere objekte duhet te paraqesin ne vendin, daten dhe oren e njoftuar prane komisionit te ankandit :

1. Dokumentin e Identifikimit
2. Kerkesen per pjesmarrjen ne ankand
3. Dokumentin bankare origjinal qe verteton pagesen 10% te vleres totale te objektit ne leke.Derdhja do te behet prane Bankes se Kursimit te cdo rrethi ne llogari te Deges AKP te rrethit perkates.
4. Vendimin e Komisionit te Kethimit te Pronave (per ish pronaret e truallit).

Afati maksimal i likuidimit te ketyre objekteve do te jete 10 vjet.

Vlera e objektit ne ankand nuk ndryshon.Ankandi zhvillohet vetem per afatin me te shkurter ne vite per te shlyer vleren e publikuar te objektit.

kuara të Amerikës George Bush: Ne u munduam të ndihmojmë vendin tuaj

Hoxhën jetonte epokat e errëta

kanë qënë më të butë me Perëndimin se Shqipëria



George Bush me gruan dhe djalin George (i riu) kandidat për president i SHBA-së

këtë çështje ?
"Ç' duan të thonë, nëse do ta kisha kryer detyrën si duhet?"

Të përdorja forcë kundër Jugosllavisë ? Megjithatë, unë jam në gjendje të kuptoj se përse disa njerëz flasin kështu. Sidoqoftë, unë paraqitem i pafajshëm përpara akuzave të tyre. Ne nuk ishim në pozitë, në vështirimin tonë, të përdornim forcë kundrejt Millosheviçit për arsye të qarta të dhashë më lart. Ndaj mendoj se historia nuk do të ma veshë mua këtë faj. Kritikant vijnë si rezultat i faktit që ne nuk patëm iniciativën për përdorim force. Të futësh 250 mijë trupa amerikane në luftë?!

Sa familje amerikane do ti dërgonin fëmijët e tyre vullnetarisht mbi kodrat e Jugosllavisë që të luftonin me luftëtarë të tipit gorilla ? Ti më thua mua që unë duhet të kisha kryer një veprim të tillë! Me jetën e kujt më do mua të luaj ? Jo shumë amerikan do ta dëshironin atë. Duhet të jemi tepër të kujdesshëm kur është fjala të aktivizojmë forca ushtarake kundrejt të tjerëve, veçanërisht kur nuk je plotësisht i bindur se si do të fitosh, cili është misioni, e kur do të jesh në gjendje të kthehesh nga lufta. Në rrethana të tilla është më mirë të mos e fillosh fare luftën. A s' të duket se pyetja që më bëre që pak e padrejtë ? Cila është pyetja tjetër që keni për mua ?"

Siç e dinë tani për një kohë mardhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Jugosllavis janë

keqësuar : A është ky një shqetësim i mëtejshëm për sa i përket ristabilizimit të paqes në Ballkan ?

"Hëh, për shumë vite, as ne amerikanët nuk kemi patur marëdhënie fare me Shqipërinë. Shqipëria ka qënë në vëmendjen tonë pothuajse e fundit nga të gjithë shtetet e botës. Edhe ish Bashkimi Sovjetik dhe Kina kanë qënë më të butë me Perëndimin se Shqipëria. Ai vënd nënë Enver Hoxhën, akoma jetonte epoka të errëta. Kur lufta e ftohtë midis nesh dhe Ruisë përfundoj, ne u munduam t' i jepnim ndihmën tonë Shqipërisë, ashtu siç duhet të bënim. Unë kam qënë në Tiranë dy herë. Ne bëmë mirë në përpjekjen tonë për ta hapur sa do pak atë vënd, kur udhëheqja shqiptare e pati dëshirën. Por ne nuk kemi ndonjëfarë obligimi të garantojmë paqe në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Këto dy vënde kanë histori të lash-të dhe të pasur konfliktesh. Nga ana tjetër, unë nuk e prisja Millosheviçin të vazhdonte një aktivitet të tillë kundrejt koso-varëve. Unë mbetem i trazuar për këto ndërprerje mardhëniesh. Po, në të njëjtën kohë, mbetem me bindjen se rrolli i Amerikës në këto dy vënde duhet të jetë vetëm rol negociator".

Duke u bazuar në eksperiencën tënde, ju jeni një fondacion me kredibilitet për t' u dhënë këshilla personave të cilët janë të interesuar në postin e presidentit. Pra, ç' do t' ju sugjeroje atyre?
"Së pari do tu këshillo-

ja të merren me politikë pak kohë para se të vendosin të paraqesin kandidaturën për president, që të jenë më të përqëndruar në mënyrën se si e reprezentojnë vetëveten në fushatë. Ata duhet të futen menjëherë në lojën e politikës. Ne kemi një sistem politik mjaft të stabilizuar. Kemi dy parti kryesore, duke përfshirë këtu edhe një parti të tretë që formohet nga njerëz të ndryshëm, me emra të ndryshëm, në kohë të ndryshme, që do të dëshiroja të mos ekzistonte fare. Them kështu sepse Amerika nuk ka nevojë për një parti të tretë, me stabilitetin politik që gëzon. Duke patur vetëm dy parti politike, kandidatit dhe votuesit kane mundësi të njihen më nga afër me njëri-tjetrin. Përfshirja me kohë në lëmin e fushatës, vetëm se i ndihmon të dy palët. Megjithatë strategjia e kandidatit për të fituar votat e nevojshme, duhet bazuar jo në sharjet dhe mangësitë e kandidatit rival, por në mundësinë dhe idetë që zotëron ky kandidat për ndryshimin dhe përparimin e vëndit. Në të njëjtën kohë mendoj se është tepër e rëndësishme që kandidatët të mosojë, të shkojë drejt njohurive të reja të politikës, duke u shoqëruar me njerëz që janë më të ngritur nga ai. Ato nuk duhet të mendojnë se dinë gjithçka, sepse ka njerëz që janë vërtetë të ndritur që e njohin mirë politikën, por ndjehen më të qetë kur qëndrojnë larg saj, Këtë e kam mësuar nga nëna ime. Më kujtohet një herë kur

Për shumë vite, as ne amerikanët nuk kemi patur marëdhënie fare me Shqipërinë. Shqipëria ka qënë në vëmendjen tonë pothuajse e fundit nga të gjithë shtetet e botës. Edhe ish Bashkimi Sovjetik dhe Kina kanë qënë më të butë me Perëndimin se Shqipëria. Ai vënd nënë Enver Hoxhën, akoma jetonte epoka të errëta. Kur lufta e ftohtë midis nesh dhe Ruisë përfundoj, ne u munduam t' i jepnim ndihmën tonë Shqipërisë, ashtu siç duhet të bënim

isha fëmijë, shenova tre gola në një ndeshje futbolli. Kur ja tregova asaj për këtë arritje, ajo mu përgjigj : "Shumë mirë, po ekipi a fitoi, George ?"

Pra puna e presidentit nuk është e lehtë. Të jesh i ndershëm, njeri me karakter dhe t' i përvishesh punës, ka më shumë rëndësi se sa të mundohesh të fi-

tosh të gjithë duelet diplomatike me ekspertët e ndryshëm të botës. Të jeshë president duhet të dishë të gjithë ato që nuk i di. Gazetarët të pyesin në konferencat e shtypit se cili është pozicioni juaj për ndryshimin e teknologjisë në aparatet kozmike. Megjithse ti nuk ja ke fare idenë se çfarë ndryshimesh

duhen bërë në këtë teknologji, ti nuk mund të thuash që nuk je i njohur sa duhet në këtë shkencë, por gjithësesi duhet të japësh një mendim. Por nuk duhet të ngutesh që nganjherë të pohosh që nuk di gjithçka. Të veprosh me efikasitet si president, ndershmëria mbetet baza reale e këtij procesi".



ISTITUTO INTERNAZIONALE GALILEO GALILEI

Porta e një rruge të sigurtë drejt së ardhmes, drejt Europës dhe kjo arrihet nëpërmjet shkollës me baza didaktike e kulturë Europiane.



Sezoni i Ri shkollor do të zhvillohet në kompleksin e ri modern në km.5 të Superstradës Tiranë-Durrës, pranë Coca-Colës. E paisur me klasa komode, laborator shkencash, teknik, informatik të lidhur me internet, laborator gjuhësor (italisht e anglisht), palestër e fushë lojrash, mense e bibliotekë. Trupi pedagogjik italian, përjashtuar mësues shqiptar për lëndët në gjuhën shqipe.

ULJE TARIFASH PER SEZONIN SHKOLLOR 2000-2001 DERI NE 30%

Për më tepër aplikohet ulje tarifash:

- 10% për pagesë të menjëhershme vjetore
- 5% për familjet që regjistrojnë më shumë se një fëmijë
- 10% për nxënësit që vinë nga shkollat e tjera me mesatare notash 10.
- Për 10 nxënës më të mirë të liceut, viti pasardhës gratis.

Në tarifa përfshihet mësimi, ushqimi, uniformat, transporti, tekstet shkollore si dhe studimi i asistuar dy orë pas mësimt.

Pranimet bëhen pa konkurs, pasi ne punojmë individualisht me të gjithë nxënësit.

Në sezonin e ri 2000-2001 do të jenë këto tipe shkollash:

- Kopësht për fëmijë
- Shkolla Fillore
- Shkolla tetëvjeçare
- Liceu shkencor
- Liceu gjuhësor
- Dega ekonomi-financë

Nxiltoni për t'u regjistruar. Shkolla fillon më 25 shtator 2000.
Për informacione të mëtejshme do të drejtoheni pranë

TIRANA INTERNATIONAL HOTEL (Salla ONUFRI)
042/34185/34901/34902/0382024902/0382020981
<http://www.galileogalilei.edu.al>